



Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit  
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/01-55202 dt. 21/12 2020

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 28/12/2020 (e Hënë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kulturës së Kuvendit të Komunës.

**THËRRET**  
**MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS**

Mbledhja do të ketë këtë:

**Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 26.11. 2020.
2. Plani i Punës për vitin 2021, i Kuvendit Komunal.
3. Plani i Punës të Kryetarit për vitin 2021.
4. Propozim Rregullorë për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.
5. Plani preliminar i Prokurimit për vitin 2021.
6. Diskutimi i Planit të Integritetit.
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit "Ngritja e Mirëqenies Sociale të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Familjarëve të tyre.
8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja joprofitabile, familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2021.
9. Propozim Vendim për këmbimin e njësive kadastrave nr. 348/0 dhe 1011/0 në zonën kadastrale në Gllogoc.
10. Propozim Vendim për përmasimin e gabimit teknik në listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.
11. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë- periferike dhe ndër urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Gllogoc, për operim.
12. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
13. Të ndryshme.

Drenas, 21.12. 2020

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 06964-55205 dt 21/11 2020

Mbledhja e rregullt  
Kuvendi Komunal  
26.11.2020

### PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **26.11.2020**

**Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30, anëtarë.**

Kuvendi filloi punimet më këtë :

#### Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.10.2020.
2. Propozim Rregullorë për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Propozim Vendim për rrënimin e ish objektit të Komunës, si dhe objekteve tjera përcjellëse.
4. Propozim Vendim për bashkimin dhe parcelizimin e parcelave kadastrale.
5. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrale Gllogoc.
6. Kodi i Etikës.
7. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.
8. Propozim Vendim për transferin e mjeteve të Kategorisë subvencione dhe transfere.
9. Propozim Vendim për shpronësimin e njërive të ndërtesave-banesave, në zonën kadastrave në Gllogoc.
10. Propozim Vendim për miratimin e listës së veçantë të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.
11. Propozim Vendim për plotësim-ndryshim të vendimit Nr.12/400/01-29727, me 29/07/2019 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL-SH .A Stacioni i Autobusëve –Gllogoc
12. Të ndryshme.

*Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 26 /11/ 2020 ishin: Nënkryetari Nazmi Hasi, Shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, këshilltarët e KK, përfaqësues të KDI-së, zyra e informimit si dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse, si dhe drejtoresha e shoqatës QPDG Kadire Tahiraj.*



**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj** -para se me shkua me rendin e ditës Kuvendi Komunal në bashkëpunim me qendrën për promovimin e të drejtave të grave ka paraparë një fushat sensibilizimi në dhunën ndaj gruas, dhe në emër të gruas e kisha ftuar asambleisten Blerina Gashi për një fjalim rasti.

**Blerina Gashi** – Përshëndetje për gjithë të pranishmit që jeni prezent këtu sot me ne :

Siç e dimë të gjithë muaji nëntor shënon fushatën kundër dhunës në familje më saktësisht në këtë periudhë shënohen me aktivitete të ndryshme 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës në familje andaj edhe ne si Komunë në bashkëpunim me Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave shënojmë sot në mënyrë simbolike këtë fushat së bashku me gjithë ju të pranishëm duke u bërë kështu zëri i gjithë atyre viktimave të llojit të tillë të dhunës dhe njëkohësisht si mënyra më e mirë e perqimit të mesazhit vetëdijësues për anët negative dhe pasojat që shkakton kjo dhunë tek qytetarët tanë .Dhuna në familje është një dukuri shumë e përhapur jo vetëm në shoqërinë tonë por edhe në të gjitha vendet e botës e cila fatkeqësisht, prek të gjitha grupet shoqërore pa dallim kulture, feje, moshe, standardi të jetës apo niveli të arsimit , ajo mund të iu ndodhë të gjithëve dhe jo vetëm grave dhe fëmijëve si viktimat me të shpeshta dhe kategori më të ndjeshme por në këtë mes hyn edhe burrat e cila më së shpeshti vije si pasojë e papunësis dhe gjendjes së rëndë ekonomike , si pasojë e mospërputhjes idesh, frustracionit (dështimi) në familje, stresi , devijimet dhe shfrenimet e anëtareve të familjes si dhe shumë dukuri tjera sociale negative. Ky fenomen negativë nga shumica e popullsisë vazhdojnë të trajtohet si një problem privat dhe që i takon vetëm familjes dhe jo shoqërisë , vështirësia e studimit rritet edhe më shumë po të kemi parasyshë se kjo dukuri ndodhë prapa dyerve të mbyllura dhe si e tillë është shumë vështirë për tu vëzhguar dhe për tu studiuar nga afër andaj edhe përkushtimi ynë jo vetëm si Komunë por edhe si shtet kërkon punë dhe përkushtim të madh drejt krijimit të një sistemi të drejtë dhe të sigurt ku bartësve të dhunës do tu jepet dënimi adekuat . Shoqëria jonë ka nevojë ti adresojë dukurit që e kërcënojnë mbarëvajtjen e saj dhe mirëqenien e qytetarit . Përpjekjet tona duhet të përqendrohen në veçanti në krijimin e një ambienti në të cilën fëmijët tanë rriten me kujdes ,dashuri dhe qasje në shkollim në frymën e edukatës së lirë nga dhuna dhe stereotipitë gjinore. Një qasje e tillë në afat të gjatë do të sigurojë zbatimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe vlerave të tjera që ne i ndajmë me civilizimin evropianë . Në mirënjohje të gjithë akterëve të cilët ndërmoren këtë nismë të përbashkët për shënimin e 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje e cila përkon edhe në një nga prioritetet jo vetëm të vendit tonë por edhe të mbarë njerëzimit dua të shprehë një falënderim të veçantë edhe për kryetarin e Komunës për mbështetjen e vazhdueshme që bënë në përgjithësi për pozitën e Gruas në shoqëri .Më lejoni të ju premtoj në angazhimin tim të vazhdueshëm jo vetëm si asamblistë e këtij kuvendi por edhe si grua dhe si vajza e dikujt në këtë luftë e cila na takon të gjithëve .Familja është bërthama e formimit të njeriut andaj familje e shëndoshë sot përkthehet në qytetar të denjë për ti shërbyer vendit nesër në mënyrë që të ndërtojmë të gjithë bashkë Komunën e pastaj edhe vendin që duam

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj**- ju ftoi për një minute heshtje ne nderim të rënies se mësuesit Halit Geci dhe në nderim të gjithë të rënëve për liri.

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj** –fjalën e merr **Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani** – sipas njoftimit shumë të shkurtër nga Ministria keni një pik shtesë është :Propozim Vendim për plotësim-ndryshim të vendimit Nr.12/400/01-29727, me29/07/2019 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL-SH .A Stacioni i Autobusëve – Gillogoc, dhe pika tjetër Propozim Vendim për miratimin e listës së veçantë të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021, edhe kjo është një krekes që nuk



ka qenë me herët po MPL-ja ka kërkuar që të shkohet përmes Kuvendit që kjo listë të miratohet në shikim të parë pastaj të vazhdojmë me procedurat tjera

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hedhin në votim rendit të ditës:

Për 24 , Kundër 1 , Abstenim 0.

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hapi për diskutim pikën e parë :

Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.10.2020.

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hedhin në votim pikën e parë : Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.10.2020.

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** kjo pikë e rendit të ditës kalon në mënyrë unanime.

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hapi për diskutim pikën e dytë : Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.

**Vehbi Berisha** –unë kam disa sugjerime edhe pse mendoj se është e mirëseardhur kjo rregullore sepse Komuna jone ka pas nevojë për një rregullore tillë ,por mendoj te neni pesë ku është para parë kompensimi për ato prona të cilat i japim në shfrytëzim, kishte qenë mirë të shtohet si paragraf për atë vit vijues d.m.th. kur të merret vendimi që vlejnë edhe ajo taks edhe ajo rregullore të jenë kompatible ,te neni gjashtë ku është pika 1.6 këtu te arsyetimi a e përcakton Komuna këtë arsyeshmerin e internist të përgjithshëm publik apo me rastin e aplikimit kur aplikon biznesi e ka për detyrë me bërë këtë ,unë mendoj që Komuna e ka për detyrë me e bërë këtë arsyeshmerin e internist të përgjithshëm publik ,të neni shtatë këtu te procedura e dhënies në shfrytëzim kishte qenë mirë me u caktua një kohë paraprakisht me ditë ne kur do të jetë afati të interesuarit me bërë aplikimin për afërsisht në fill a në mes të vitit d.m.th. me u caktua një kohë ,sepse atje tek procedura e ankesave e kemi decedivisht të qartë se sa janë afatet detyrimeve pas shpalljes se fituesit ,ndërsa te kushtet për aplikim me intereso këtë pika 1.4 që është historiat i biznesit që aplikon a duhet të zgjidhet nga ARDK-ja apo është një formë tjetër që ndoshta unë nuk jam në njohuri ,dhe me intereson ta di se si me rastin e aplikimit si përmbushen kushtet faleminderit .

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** – kjo rregullore është e harmonizime në nivel vendi nga asociacioni i Komunave të Kosovës, të neni pestë ne e kemi obligim me bërë, rregullore për taksa çdo vjet sepse niveli qendror i përcakton taksat dhe jemi të detyruara , të neni gjashtë drejtoria përkatëse përcakton kushtet edhe e nënshkruan këtë marrëveshje ,neni shtatë d.m.th. kërkesat kur behën caktohen nuk kalon me shumë ,mund ta kemi një leje me dhen prej pese minat deri ne 365 ditë ,sa i përket kushteve për aplikim ai që aplikon i ka edhe kushtet ne kërkesë ,ne i kemi të dhënat ne ARDK, por mund edhe mos me qenë biznes si p.sh. sjell dikush me sjell ndonjë kamion me miell ,dru ose tjetre lloj e ka për obligim me kërkuar leje ,pastaj duhet me blloku atë segment të rrugës ,ose atë parking faleminderit ju ftoi të votoni.

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hedhin në votim pikë e dytë :Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Në mënyrë unanime kalon kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hapi për diskutim pikën e tretë : Propozim Vendim për rrënimin e ish objektit të Komunës, si dhe objekteve tjera përcjellëse.

**Petrit Gashi** – përshëndetje për të gjithë në fakt kur e mora këtë propozim vendim mendova që do të kemi edhe një arsyetim ne fund se pse duhet të rrënohet objekti ose në fakt se si do te orientohet ajo pjese e parcelës, për çka do te ri destinohet ajo pjesë. Ne fakt nuk gjeta asgjë



përveç se disa numra të parcelave të cilat e përbejnë pjesën e objektit për rrënimin e tyre mirëpo nuk ka ndonjë arsyeshmëri të qarte se çka do të bëhet me atë vend dhe çka do të ndërtohet në atë vend, ku do të mbesin ato zyrat të cilat i shfrytëzojnë qofte të rinjtë qofte të tjerët të cilët e kanë objektin e vjetër dhe njëkohësisht pra me e pasur të paktën një plan të cilin vizuelisht, në do ta kemi përpara dhe do të duket ajo pjesë pas rrënimin e objektit dhe si do të rregullohet. Kërkoj nga Kryetari me e na sqarua se pse është e arsyeshme rrënimin e këtij objekti dhe çka pas rrënimin të tij, çka do të ndërtohet pas rrënimin të tij.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** – Ju të gjithë e dini se tash me objekti është jashtë funksionit sepse është një objekt shumë i vjetër i ndërtuar në katin e dytë me cilësi të dobët të materialit, janë vlerësuar që janë kalbur dhe ekziston rreziku që me u shemb, e dyta është që kanë filluar me përdor edhe të miturit, fëmijët të cilët po e përdorin për formë të ndryshme, po hynë brenda në objekt, po hyjnë edhe nga ana e policisë lëre me edhe përpara ndërsa sa i përket asaj se e kanë një zyrë ose dy zyre rinia për ta shfrytëzuar, në jemi përgatitur objektin për rini të shkolla fillore Rasim Kiqina dhe qendrat për promovimin e drejtave të grave do të kalojnë në objektin ku e kemi ndërtuar po thuajse për atë qëllim, jo kontratë të përhershme por deri sa të bëjmë zgjidhje, ndërsa në planin zhvillimor që e kemi votuar vetë do të përcaktohet për sallë dhe objektet e tjera që do të jenë në shfrytëzimet Komunës.

Sabrije Kukaj –unë veç e mora përgjigjen isha e interesuar të di se ku do të mbeten shoqata e grave që është duke e bërë një aktivitet të jashtëzakonshëm, po ashtu e mora përgjigjen që shtëpia e kulturës qenka në plan me u ndërtua ai që e merr me koncesion.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** –aty e kemi edhe arkivin dhe në shumë shpejt do të sistemojmë edhe arkivin në do të bëjmë një marrëveshje me objektin e bashkësisë islame nga i cili në si Komunë i kemi 25 % të objekteve dhe atë objekte do ta ndajmë për nevojat e Komunës qoftë edhe për arkivin edhe për drejtoritë tjera.

**Sokol Bylykbashi** – u përmend edhe me herët që ky dokument që përveç qëllimit ku përmendet vetëm plani zhvillimor në të cilin ka mungesë detajesh është dashur edhe një arsyetim, ku me ato arsyeime mundemi me kuptua pse po rrënohet dhe çfarë do të bëhet, në parim unë jam për me u rrënua ky objekt sepse është i pa përdorshëm edhe nuk besoj që është objekt që ja vlen me pas si trashëgimi, është mirë që për çdo propozim vendim të këtij arsyetim në mënyrë që të mbete si dëshmi e shkruar, pra është e rëndësishme çfarë parashihet të ndërtohet në këtë parcelë kryetari e përmendi vetëm me e dhënë në shfrytëzim, pyetja ime është se ka me u bërë me këtë parcelë? Mos vallë ndonjë ndërtim i lartë të cilën unë në mënyrë kategorike e kundërshtoi.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** –në jemi para ndërtimit të hartave zonale, kemi me pas dëgjime publike, diskutime edhe kemi me bërë propozime unë kam parë edhe arkitekt të ndryshëm që do të bëjnë projekte për të cilat në do të dakordohemi, ai që është në parim për me e rrënua një objekt i cili nuk ja vlen me qëndrua sepse e rrezikon jetën e qytetarëve vetëm ju garantoj se kush do që ka me marrë ka me pas detyrim me pas një sallë edhe me të mirë se kjo që e kemi dhe me i pas objekte të cilat ka nevojë Komuna faleminderit.

**Sokol Bylykbashi** –d.m.th. kryetar ti le me u kuptua që këtu ka me pas banesë të ndërtimit të lartë, dhe kjo nuk është në rregull.

**Vehbi Berisha** – edhe unë ndaj mendimin e njëjtë me parafolësit e mi që këtij propozimi ti bashkëngjitet arsyetimi dhe të mbete i shkruar dhe jo të shikojmë proces verbalin se kush çfarë ka thënë në lidhje për rrënimin e këtij objekti. Ajo që me interesoi mua personalisht u gëzova që në fund institucionet të cilat e shfrytëzojnë këtë objekt sado që i vjetër që është edhe pse në vazhdimësi janë bërë riparime të ndryshme që në fatkeqësisht në po hasim në mungesë strategjie për planifikime afatgjate kur them mungesë strategjie planifikimit afatgjate sepse në të ardhmen



shumë objekte të tjera i pret i njëjti fat p.sh nuk po dua me tërheq vëmendjen , sa milionat i kemi dhëne nder vite për me riparuar dhe për rindërtuar objekte me qendrës kryesore familjare sikur qe është pare edhe ne planin zhvillimore do te rrezohet dhe do të ndërtohet e reja ,atëherë kur e kemi pasur ne plan pse i kemi dhëne gjithë ato mjete , kishte qene mire prej fillimit me ndërtuar. Tek kjo çështje me intereso Kryetar a është bere ndonjë plan dinamik, a e dimë qe do te mbesim pa salle një vit apo dy vite sepse kultura do te pësoi nga mungesa e kësaj salle siç e dimë te gjithë ndoshta edhe nga disa vite te tjera jam pro rrënimit te objektit sepse u tha edhe nga Kryetari sepse kemi edhe informata qe objekti i vjetër nuk ka pasur pllake fare po përafërsisht Kryetar a mundemi me ditur sa na merr kohe kjo procedure derisa sa na mundemi me i rikthyer disa objekte siç është salla e kulturës ne këtë rast.

**Ramiz Lladrovci** – Sa i përket sallës se kulturës ju e dini qe kjo salle është shfrytëzuar pothuajse prej Marsit veç prej neve një here a dy e kemi shfrytëzuar edhe për aktivitete te tjera , ne kemi halla te sporteve , kemi salla te sporteve , kemi salla te tjera te cilat do ti shfrytëzojmë deri ne momentin kur do ta kemi sallën e re ose sallën e kulturës te re. Sa do te zgjas unë nuk jam parashikues por unë besoj qe nga sot nja 3 vite me se paku ose 4 vite ka me zgjatur derisa te kryhet qe te funksionalizohet një salle ose një objekt i caktuar qe ka me qene i nevojshëm për komunën .

Sokol Bylykbashi – nëse unë kam një propozim se nuk bane me u ndërtua në atë vend ku është Komuna banesa sepse e ke ne derë të komunës .

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**- Kuvendi komunal vendos me shumicë votash , unë po them se cili është propozimi me i mirë unë do të mbështes .

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj**- hedhin në votim pikën e tretë :3 Propozim Vendim për rrënimin e ish objektit të Komunës, si dhe objekteve tjera përcjellëse.

**Për 25 , Kundër 0 , Abstenim 2.**

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj**- hapi për diskutim pikën katër.4 Propozim Vendim për bashkimin dhe parcelizimin e parcelave kadastrale. Diskutime nuk pati prandaj kryesuesi e hedh ne votim këtë pikë të rendit të ditës.

**Për 25 , Kundër 0 , Abstenim 2.**

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj**- hapi për diskutim pikën e pestë 5.Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrale Glllogoc.

**Petrit Gashi** – unë po kërkoj një sqarim pse duhet të këmbehen këto parcela dhe cili është përfitimi që ka komuna e jonë do të bëj për këmbimin e këtyre parcelave pa pasur ndonjë arsytim sepse shpesh here e shohim vetëm kërkesën e pronareve për ndërrim te pronave por nuk e shohim edhe një arsytim se cili do te ishte interesi publik i komunës tone që te beje këmbimin e këtyre pronave apo vetëm plotësim i dëshirës te parashtruesve të kërkesës në këtë propozim vendim .

**Ruzhdi Lestrani**- Përshëndetje për te gjithë ,te pika 3 e këtij propozim vendimi është një gabim teknik i cili duhet me u përmirësua ,mirëpo këmbimet e këtyre parcelave janë te domosdoshme si për pronarin e kësaj pronë ,po ashtu edhe për komunën se pse pronari privat i cili e ka bërë kërkesën prona e tij na e ka blloku pronën tonë që e kemi ne mbrapa tij dhe nuk kemi qasje dhe nuk mundemi me i bashku dy pronat tona ne mes dy pronave tona është prona e këtij pronarit privat ,pra qelli është që ne ti bashkojmë pronat tona në njërën anë pronari ne anën tjetër dhe te kemi qasje ne rruge kryesore .

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj**- hedhin në votim pikën 5.Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrale Glllogoc.

**Për 25 , Kundër 0 , Abstenim 1.**



**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hapi për diskutim e gjashtë: Kodi i Etikës. **Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani** –Kodi i Etikës është standard për të gjitha Komunat .

**Petrit Sinani** – Kodi i Etikës është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm për zyrtaret publik ,për ata të emëruarit politik po ashtu edhe zyrtaret ne administratën publike unë të neni 5 pika 2 kërkoi një sqarim sepse është në kundërshtim me kodin komision zgjedhor të zgjedhjeve ,pikë tjetër për të cilën unë mendoi qe duhet me u diskutu është zbatimi i masave disiplinore ,d.m.th. dënimi me ndalje deri ne 15% të pagës për tre muaj të keni parasysh është mirë me e lexua këtu shihet me u themelua një komision i cili ka me qenë përgjegjës për me e zbatua kush e ka shkel këtë kod e kush jo d.th.th zakonisht ne modelet e kodit të etikes parashihet edhe një far si doracaku se cilat janë detyrat dhe përgjegjësit e këtij komisioni kur një zyrtar e shkel këtë kod sa penalizohet ai .

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**-sa i përket për asamblistë nuk vlen sepse komisioni qe do te përcaktohet është për zyrtar jo për asamblistë ju mundeni me e formua një komision të juajin edhe me marr masa ,sepse ne nuk kemi drejt me formua komision i cili i dënon asamblistë ne bazë te kodit .

**Petrit Sinani** –ka kundërshtime te neneve me vet veten ,dhe mos të harrojmë që ne bazë te këtij kodit mund të largohen njerëzit prej pune sepse është ne ligj të Kosovës për zyrtar publik faleminderit .

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**-nuk përjashtohen njerëzit me vërejtjen e parë me te treten mund të shkon ne komision disiplinor dhe të përjashtohet .

**Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani**-sa i përket të zgjedhurve te popullit ka të bëj ne aspektin moral jo në aspektin ndëshkimor me përqindje të pagës .

**Vehbi Berisha** –shqetësimin e kolegut e vlerësoi të drejt tash a moral a ligjor në momentin që një kod hyn ne fuqi aty ai dihet qe duhet me u aplikua ne mundemi me i dhënë një zgjidhje tjetër kësaj qeshte të asamblistëve ,mundemi me ja shtua një paragraf qe qeshtja e të zgjedhurve publik rregullohet me rregulloren e kuvendit ne atë rregullore te Kuvendit mundet me u bërë një komision edhe me e amandamentu se pse kemi nevojë me e bërë një rregullore sepse prej kohës kur ka qene Idriz Hyseni Kryesues me ajo rregullore nuk është riamandamentu ,dhe ka nevojë për rishikim prandaj mënyra me e mir me e zgjidh këtë problem kishte me qene kjo .

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** sa i përkete asamblistëve janë ligjet ,rregulloret ne mundemi me kthi ne diskutim në seancat tjera .

**Petrit Sinani** -nëse merren parasysh të gjitha këto rekomandime të gjithë se cilit prej neve atëherë të inqizume janë dhe vazhdojmë e bëjmë kodin sepse ky kod është ne shpërputhje me vete veten këto janë dilemat e mija .

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** rregullorja e përcakton kur i humbet mëditja një asamblisti .

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**- unë nuk kam me shtua asgjë vetëm se ju ftoi me votua kështu si është, ligje përcakton që komisioni nuk mundet me marr masa ndaj asamblistëve normal rregullorja është e harmonizuar ne nivel të gjitha Komunave të Kosovës .

**Petrit Sinani**- komuna e Vushtrisë e ka ndryshe , kryetar Gjilanit ndryshe, ne e kemi ndryshe sepse unë i kam tri rregulloret dhe ka dallime .

**Për 29 , Kundër 0 , Abstenim 1.**

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hapi për diskutim pikën 7.Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.



**Drejtori Financave Shyqiri Byblaku** –përshëndetje për të gjithë ne e kemi marr shkallen me te ulëte 15 % duke marr për bazë edhe gjendjen pandemike në te cilën ndodhemi ,po ashtu për te gjitha shkallet në të gjitha sektorët kemi shkuar me shkallën minimale .

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hedhin në votim pikën 7.Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

Kjo pikë votohet bë mënyrë unanime .

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hapi për diskutim pikën 8.Propozim Vendim për transferin e mjeteve të Kategorisë subvencione dhe transfere.

**Drejtori Financave Shyqiri Byblaku-sa i përket** Propozim Vendimit për transferin e mjeteve të Kategorisë subvencione dhe transfere.,kemi mjete te cilat nuk janë shpenzua mirëpo akoma nuk e kemi mjete te alokuara të ndara sepse ende nuk kemi arrit me i realizua të gjitha ,por për me mund me i mbulua shpenzimet e familjeve të cilët kanë student për të cilët ky vit ka qene mjaft i vështire për këtë arsye kemi para parë qe mundësisht në një periudhë kohore të shkurtër me i ndarë këto mjete dhe me i transferu te drejtoria për arsim dhe të ia lehtësojmë sa do pak studentëve të komunës sonë .

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-**problemi është që ne kemi para par 160 bursa për student kanë aplikua 213 nëse nuk gabo i edhe me shumë kanë aplikua por kriteret i kanë plotësua 213,dhe duke e parë që na kanë mbet subvencionet pa shfrytëzua për shkak të pandemisë ,kemi propozua që këta student që i kanë plotësua kriteret me i subvencionua me bursa dhe ju ftoi të votoni këtë propozim për studentë .

**Petrit Gashi** –pyetja ime ishte rreth sqarimit te kryetarit për këtë propozim vendim por gjithçka është në rregull .

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hedhin në votim pikën 8.Propozim Vendim për transferin e mjeteve të Kategorisë subvencione dhe transfere..

Kjo pikë votohet në mënyrë unanime .

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hapi për diskutim pikën 9.Propozim Vendim për shpronësimin e njësive të ndërtesave–banesave, në zonën kadastrave në Glllogoc.

**Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-**ky është një nder vendimet që janë dërguar për ligjshmëri seancën e kaluar dhe me kërkesë të ministrisë se e ekonomisë dhe ambientit ka kërkuar përmes MPL-së nga ana e komunës se Glllogocit që të bëj harmonizimin e vendimit paraprak i cili ka qene për shpronësimin e zonave te paluajtshme ,ne e kemi bërë këtë harmonizim dhe e kemi dërgua këtë kërkesë të tyre si rishqyrtim ne MPL

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hedhi në votim pikën 9.Propozim Vendim për shpronësimin e njësive të ndërtesave–banesave, në zonën kadastrave në Glllogoc.

**Për 24 , Kundër 2 , Abstenim 2.**

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hapi për diskutim pikën 10.Propozim Vendim për miratimin e listës së veçantë të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.

**Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-**sipas kërkesës së të Ministrisë se e Ekonomisë dhe Ambientit ka kërkuar përmes MPL-së që Propozim Vendimi për miratimin e listës së veçantë të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021. Të kaloi për herë të tret ne Kuvend .

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj-** hedhi në votim pikën10.Propozim Vendim për miratimin e listës së veçantë të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.

**Për 25 , Kundër 0 , Abstenim 3.**



**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj**- hapi për diskutim pikën 11.Propozim  
Vendim për plotësim-ndryshim të vendimit Nr.12/400/01-29727, me29/07/2019 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL-SH .A Stacioni i Autobusëve –Glllogoc  
Pasi diskutime nuk pati :**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj**-në mënyrë unanime kalon kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i kuvendit komunal Labinot Halilaj**-të pika të ndryshme a ka dikush diçka ?

**Sokol Blykbashi**-e kam një pyetje po edhe një ankesë të një qytetari nga fshati Arllat, ai thotë se nuk është bërë asnjë investim ne lagjen e xhamisë ,dhe ankesa është se fëmijët ,nxënësit e lagjes Foniqi po kalojnë një asfalt tek i cili mbulohet kanalizimi ku depërton kanalizimi në asfalt nëse mundeni me jep ndonjë sqarim.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**-drejtori nuk është këtu me jep më saktësisht përgjigje por nëse ka nevojë të sqaroi me shkrim faleminderit .

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11: 30. min.

Procesmbajtëse:



Fakete Hoti







**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**Komuna e Drenasit**  
**Zyra e Kuvendit**



**Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2020, si vijon:**

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca se kemi dhe tri pika shtesë për rendin e ditës : 1. Propozim Vendim për përmasimin e gabimit teknik në listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.

2. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë- periferike dhe ndër urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc, për operim.

3. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan më tri pikat shtesë me rendin e ditës, dhe u aprovua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët:

**- Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 19.11.2020.

**- Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

2. Plani i Punës për vitin 2021, i Kuvendit Komunal.

**- Rekomandohet për Kuvend**

3. Plani i Punës të Kryetarit për vitin 2021.

**- Rekomandohet për Kuvend**

4. Propozim Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

**-Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

5. Plani preliminar i Prokurimit për vitin 2021.

**-Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

6. Diskutimi i Plani të Integritetit.

**- Rekomandohet për Kuvend**

7. Propozim Vendim për financimin e Projektit “Ngritja e Mirëqenies Sociale të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Familjarëve të tyre.

**-Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja joprofitabile, familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2021.

**- Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

9. Propozim Vendim për këmbimin e njërive kadastrave nr. 348/0 dhe 1011/0 në zonën kadastrale në Glllogoc.



**-Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

10. Propozim Vendim për përmasimin e gabimit teknik në listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.

**-Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

11. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë- periferike dhe ndër urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc, për operim.

**-Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

12. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**-Rekomandohet për Kuvend.**

13. Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11: 30.

Kryesuesi i Kuvendit

Labinot Halilaj





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12-030-54150 dt. 15. 12 2020

**PLANI I PUNËS**  
**SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN**  
**2021**

Dhjetor, 2020



